



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.05.2023

Nr: 81

Ora: 18:00

**URDHËR**

**MBI**

**ADMINISTRIMIN E PAJISJEVE ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT (PEI), TË TË DHËNAVE QË  
ATO MBARTIN, SI DHE MBI MARRJEN DHE ADMINISTRIMIN E ÇDO INFORMACIONI TJETËR  
QË LIDHET ME PËRDORIMIN E PEI NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË  
DATËS 14 MAJ 2023.**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

**URDHËROJMË:**

1. Anëtarët e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të caktuar si pjesë e grupit të punës së ngritur në zbatim të urdhrit nr. 78 datë 16.05.2023 “Për verifikimin e shkaqeve të mosfunksionimit të PEI në disa qendra votimi në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023” do të kenë edhe detyrat si më poshtë:
  - a) Të identifikojnë qendrat e votimit për të cilat nuk u dërgua informacion në KQZ nëpërmjet PEI në kohë reale;
  - b) Të identifikojnë qendrat e votimit nga të cilat nuk u dërgua informacion në KQZ nëpërmjet PEI në kohë reale, por rezultojnë që identifikimi i zgjedhësve është bërë nëpërmjet PEI;
  - c) Të identifikojnë qendrat e votimit në të cilat nuk u caktua operator teknik për përdorimin e PEI;
  - d) Të evidentojnë qendrat e votimit në të cilat nuk u paraqit operatori teknik i caktuar nga KQZ, si dhe shkaqet e mosparaqitjes së tyre;

Data: 20.05.2023 Nr: 81  
Ora: 18:00



Për vazhdimin e punës për pajisjet elektronike të identifikimit (PEI) që kanë trasmetuar gjatë ditës së zgjedhjeve

- e) Të evidentojnë listën e PEI të cilat do të përdoren si rezervë/zëvendësues në rastet përkatëse;
  - f) Të evidentojnë qendrat votimit në të cilat u bë zëvendësimi i PEI dhe ora kur është bërë ky zëvendësim;
  - g) Të verifikojnë nëse në qendrat e votimit në të cilat PEI u zëvendësua, identifikimi i zgjedhësve është bërë nëpërmjet PEI (nëse PEI ka funksionuar);
  - h) Nga qendrat e votimit ku identifikimi është bërë nëpërmjet PEI, përjashto ato qendra nga të cilat ka patur transmetim të informacionit nëpërmjet PEI, të verifikojnë kur është hapur procesi i identifikimit dhe kur është mbyllur;
  - i) Të verifikojnë se cila PEI, sipas numrit përkatës serial të saj dhe të valixhes mbajtëse, është dorëzuar në cilën qendër votimi;
  - j) Të verifikojnë dhe të shënohen kodet e sigurisë të çdo PEI dhe të valixhes përkatëse mbajtëse;
  - k) Të kryejnë kontrollin fizik dhe të evidentojnë pjesët fizike që gjenden në çdo valixhe PEI, si dhe gjendjen e tyre;
  - l) Të kryejnë transferimin e të dhënave të PEI të cilët kanë transmetuar informacion në KQZ në kohë reale, në në sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV) në KQZ nëpërmjet sistemit wireless;
  - m) Të konsolidojnë në sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të dhënat që gjenden në memorien e brendshme të pajisjes elektronike të identifikimit (PEI) dhe në USB;
2. Kryerja e transferimit të të dhënave për të gjitha PEI nëpërmjet leximit të USB të brendshme do të bëhet në momentin kur grupi i punës do të ketë në përbërje të tij të paktën një përfaqësues të shoqërisë furnizuese të PEI;
  3. Për çdo PEI të hapet një kartelë digjitale e cila do të përmbajë informacion në lidhje me të dhëna identifikuese dhe teknike të vetë PEI, pjesët përbërëse, si dhe çdo të dhënë tjetër që lidhet me përdorimin e kësaj pajisje, si të tilla por jo vetëm, qendra e votimit ku është përdorur, koha e përdorimit, personi që e ka konfiguruar për përdorim për identifikim, etj.
  4. Për çfarë parashikohet në këtë urdhër si dhe në urdhrin nr. 78 datë 16.05.2023 “Për verifikimin e shkaqeve të mosfunksionimit të PEI në disa qendra votimi në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023”, me përjashtim të çfarë parashikohet në pikëm 2, germa “c” të tij, grupi i

punës i dorëzon Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, një raport mbi gjetjet jo më vonë se 30 ditë nga dalja e këtij urdhri.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshëm të Administrimit të Zgjedhjeve, Drejtoria e Logjistikës dhe e Digjitalizimit për zbatimin e këtij urdhri.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**